



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e -III-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
16 prill 2018 në sallën e Kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:05.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka, Lutfi Bilalli dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Munguan: Shpëtim Zhegrova dhe Melihate Basholli – Latifi.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Besim Muzaqi (nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Miran Halili, Adnan Lahu, Berat Sadiku, Berat Asllani, Sylejman Mehulli), Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore, Isak Hyseni, kryesues i Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta, Saim Berisha, kryesues i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Fatmire Krasniqi, kryesuese e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, nga sekretaria e kuvendit: Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ai deklaroi se kanë ardhur disa propozime që të futen në rend të ditës:

- a. Shqyrtimi i Raportit tremujor janar-mars 2018 mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
- b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vushtrisë për periudhën 2019-2022;
- c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për prona të paluajtshme dhe
- d. Shqyrtimi i kërkesës të Shoqatës të Invalidëve të UÇK-së- Dega në Vushtrri për ndihmë financiare për shërimin e invalidit të UÇK-së, Isa Murati.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 14.03.2018;
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrisë;
4. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore;

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për vitin 2017;
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2017;
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit për vitin 2017;
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike për vitin 2017;
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2017;
10. a. Shqyrtimi i Raportit tremujor janar-mars 2018 mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
- b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2019-2022;
- c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për prona të paluajtshme dhe
- d. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës të Invalidëve të UÇK-së- Dega në Vushtrri për ndihmë financiare për shërimin e invalidit të UÇK-së, Isa Murati.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 14.03.2018.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – i njoftoi të pranishmit se qëllimi i këtij ndërrimi të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore ka të bëjë me ndërtimin e një dhome për prodhimin, përpunimin dhe promovimin e mjaltit në fshatin Beçiq. Ai tha se lidhur me këtë kemi marrë pëlqimin nga ana e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se lidhur me çështjen e ndërrimit të destinimeve të tokave, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë duhet çdo herë të dalë në terren dhe ta bëjë verifikimin e parcelave. Kjo për shkak se në kadastër figurojnë toka bujqësore, një pjesë e madhe e pronave në qytet. Nuk jam kundër që të bëhet ky ndërrim, mirëpo të krijohet një komision dhe të verifikohet se ajo tokë a është tokë bujqësore.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se pajtohet me atë që e tha Neziri, sepse një pjesë shumë e madhe në zonën urbane të qytetit në kadastër figuron tokë bujqësore. Prandaj, jemi duke vlerësuar gjendjen se si të veprojmë në këtë drejtim.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore – tha se sa i përket rastit në Beçiq, nuk po shoh asgjë kontestuese në bazë të dokumentacionit që kemi. Sa i përket terrenit nuk e di si është gjendja. Mirëpo, nuk shoh pengesa ligjore që të procedohet në kuvend.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrisë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – tha se në komunën tonë nuk ekziston besueshmëria e produkteve, për shkak të skadimit të afatit. Sipas saj, numri i ankesave është shumë i vogël dhe s'po më duket që janë të vërteta këto të dhëna. Ajo pyeti se a ka nevojë për inspektime më të shpeshta.

Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektime – lidhur me ankesat, theksoi se ky numër i ankesave është ai numër i ankesave zyrtare që është raportuar në drejtori. Tutje tha se gjithsesi që duhet të ketë inspektim shtesë, por kemi nevojë edhe për inspektorë shtesë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se kjo çështje është një nga temat që është diskutuar në mbledhjen e bordit me drejtorë. Muzaqi theksoi se ende nuk i kemi kapacitetet e duhura për të bërë kontrole të mjaftueshme. Prandaj, jemi duke bërë përpjekje që të rrisim numrin e punëtorëve në Drejtorinë për Inspektime. Sipas Muzaqit, duhet të punohet edhe në drejtim të përgatitjes së procedurave të inspektimit (të cilat deri më tani i kanë munguar inspektoratit) dhe të kemi procedura standarde, në mënyrë që kur inspektori del për të inspektuar ta ketë një protokoll të veçantë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për vitin 2017

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se ky nuk është një raport, por është procesverbal. Në vend që të marrim ide dhe sugjerime nga këto komitete, ne po duhet të diskutojmë që t'i mësojmë se si t'i shkruajnë raportet.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – theksoi se është shqetësuese mospjesëmarrja e dikujt prej anëtarëve të komitetit në KPF. Ky raport duhet të përpunohet dhe të dërgohet në kuvend.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – kërkoi nga sekretaria që t'ua përgatisin një draft-raport dhe të bëhet një model për këto komitete. Pastaj tha se edhe unë pajtohem që ky komitet ta plotësojë raportin për kuvend.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se ky raport është mirë t’iu kthehet dhe ta marrin më seriozisht punën e tyre. Ai tha se nuk është mirë t’iu ndihmohet me improvizuar.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – u shpreh se është shqetësuese mosprezenca e kryesueses së këtij komiteti në këtë takim. Duhet të tregohen serioz në punën e tyre. Edhe unë jam i pajtimit që t’iu kthehet ky dokument dhe mos të procedohet në kuvend.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – tha se sipas meje, varianti më i mirë është që ta shtyjme për ndonjë mbledhje shqyrtimin e këtij raporti.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për” dhe një (1) “kundër” kërkoi që ky raport të plotësohet dhe pastaj të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2017

Saim Berisha, kryesues i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - në pika të shkurtra prezentoj raportin.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – pyeti lidhur me vizitën e këtij komiteti në Njësinë e ujësjellësit në Vushtri. Në raport thuhet se përgjegjësi i kësaj njësie tha se “gjendja e ujit është përmirësuar dukshëm, pas fillimit të punës së fabrikës, ku kemi furnizim me ujë mbi 20 orë, si dhe kontrollet dhe klorizimi janë të rregullta”. Sa është e vërtetë kjo?

Saim Berisha, kryesues i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - ne gjatë vizitës në këtë njësi, i kishim kërkesat tona lidhur me fshatrat që nuk janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit, kurse përgjegjësi i kësaj njësie i bënte reklamë punës së vet, duke theksuar se janë ndërruar shumë gypa në qytet.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – në këtë raport keni shkruar se: “puna e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (KKSHMS) është karakterizuar nga një frymë demokratike dhe tolerante ndërmjet anëtarëve”. Çka nënkupton kjo?

Saim Berisha, kryesues i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - tha se kjo nënkupton frymën e bashkëpunimit që mbretëron brenda grupit. Pra, kemi një bashkëpunim të mirë si ekip.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – e përgëzoi këtë komitet lidhur me përpjekjet dhe angazhimin e tyre. Ai pyeti se a janë plotësuar rekomandimet e komitetit tuaj nga ana e komunës.

Saim Berisha, kryesues i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - theksoi se përgjigje me shkrim lidhur me rekomandimet tona nuk kemi marrë asnjëherë. Ai kërkoi që të paktën t’iu kthehet ndonjë përgjigje.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se rekomandimet janë të mirëseardhura çdoherë dhe se disa prej tyre veç janë duke u implementuar. Në këtë raport

janë bërë edhe disa konstatime, si në rastin e ujit të pijes, gjë që nuk është në kompetencën e komitetit konsultativ. Komiteti është dashur që t'ua kërkojë raportin e analizave të ujit se ku bëhen. Çfarë standardi plotësojnë, sepse, këto i takojnë lëmit të shëndetësisë, u shpreh ai, i cili shtoi se kjo është ajo që na intereson në aspektin shëndetësor, se uji që iu ofrohet qytetarëve, qoftë 1 orë, qoftë 24 orë, se a është ujë i pijshëm.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – kërkoj që të bëhen disa përmirësime për kuvend, sepse raporti ka të bëjë me vitin 2017, ndërsa ka disa aktivitete që janë përfshirë edhe për vitin 2016.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – u shpreh se në këtë raport është paraqitur vetëm gjendja në fabrikën e ujit në Balincë, kurse ne e dimë që shumë fshatra nuk janë të kyçura ende në rrjetin e ujësjellësit. A keni mundur ju si komitet ta hulumtoni gjendjen në terren dhe të dihet se çfarë uji pinë banorët e fshatrave të Vushtrrisë, të cilët nuk janë të kyçur në rrjet. Ai tha se më vjen mirë që në fillim të vitit 2017 është punësuar një kimist për analiza në fabrikën e ujit në Balincë, sepse, në fund të vitit 2016 e kam vizituar fabrikën me një grup të nxënësve, kurse analizat i ka bërë një laborant me shkollë të mesme, që për mua kjo ishte shqetësuese. Ai tha se në këtë raport është paraqitur edhe se shumë shkolla nuk janë të përfshira në rrjetin e ujësjellësit dhe kjo është shqetësuese, sepse gjendja e puseve nëpër shkolla nuk është e mirë, në bazë të disa analizave që po i bëjnë kompanitë e ndryshme. Prandaj, t'i rekomandohet Drejtorisë për Arsim që sa më shpejt ta bëjë kyçjen e shkollave në rrjetin e ujësjellësit.

Saim Berisha, kryesues i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - tha se vitin e kaluar patëm planifikuar që në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (e cila na ofroi mbështetjen e saj) të dalim në terren dhe t'i vizitojmë shkollat nëpër fshatra. Mirëpo, për shkak të zgjedhjeve, u bënë ndryshimet në qeverisje. Prandaj, po shpresojmë se me drejtorin aktual të shëndetësisë do të kemi bashkëpunim të mirë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri kërkoj që të bëhen disa përmirësime dhe pastaj të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit për vitin 2017

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – ju si komitet keni rekomanduar që një sipërfaqe prej 1805m² tek magjistralia Mitrovicë-Vushtri të gjelbërohet dhe të mbjellën drunj të tipit “Pawlovnia”. A keni informata se a është marrë për bazë rekomandimi i juaj dhe a është gjelbëruar ajo sipërfaqe.

Fatmire Krasniqi, kryesuese e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit- tha se ne si komitet e kemi dhënë këtë rekomandim, ndërsa përgjigje me shkrim nuk kemi marrë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se ne si qeverisje rekomandimet e komiteve konsultative, të cilat janë të arsyeshme, do t'i trajtojmë me kujdesin maksimal

dhe do t'i fusim në planet tona të punës. Po ashtu, do t'iu kthejmë përgjigje komiteteve se deri ku kanë shkuar rekomandimet e tyre.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se brenda këtij komiteti po e shoh që janë të pranishëm një grup i profesionistëve. Tek fusha e ndërtimeve, në raport thuhet se: “ 70% e hapësirës të jetë parking dhe gjelbërim, kurse vetëm 30% ndërtim”. Klinaku pyeti se a e kanë konsultuar ligjin e ndërtimeve. Në raport është shkruar lidhur me rregullimin e lumit “Silnica” në parametra që i keni paraqitur. Konsideroj se rregullimi i lumit “Silnica” nuk është kompetencë e komunës, theksoi Klinaku.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – e përgëzoi ekipin e komitetit për hartimin e këtij raporti.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se është një raport që është punuar me përkushtim, duke përfshirë skicat që janë paraqitur.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se shumica e rekomandimeve që janë paraqitur në raport janë në Planin Zhvillimor Komunal. Feka tha se plani është përfunduar dhe se këto rekomandime nuk na hyjnë në punë. Ai pyeti se para se të bëhet plani zhvillimor, a keni marrë pjesë në ndonjë diskutim publik dhe se a keni dhënë rekomandime.

Fatmire Krasniqi, kryesuese e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit- lidhur me fushën e ndërtimeve theksoi se rekomandimet që janë dhënë janë bazuar në Ligjin e ndërtimeve. Ndërkaq, lidhur me planin zhvillimor komunal, Krasniqi shtoi se si komitet kemi mbajtur një takim të përbashkët me drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambienti, si dhe me ish-kryesuesin e kuvendit, ku ne si komitet i kemi dhënë rekomandimet tona për planin zhvillimor.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike për vitin 2017

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se nuk është në rregull që dikush prej këtij komiteti mos të marrë pjesë në takim.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi është shqetësuese hartimi i këtij dokumenti që nuk është raport, por procesverbal.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se qëndroj prapa asaj që t'iu bëhet një formë (draft) e raportit se si ta hartojnë raportin.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – u shpreh se duhet të gjendet ndonjë mekanizëm ndëshkues për mospjesëmarrjen e tyre.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se jo vetëm mekanizëm ndëshkues, por kisha thënë ta gjejmë një mekanizëm “çlirues”, që të çlirohem prej këtyre komisioneve që janë aq formale, që edhe raportin formal nuk e adaptojnë që ta bëjnë të besueshëm.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se këto komitete e kanë marrë punën joserioze, ndoshta për shkak se rekomandimet e tyre nuk janë përfillur. Prandaj, konsideroj se qeveria komunale duhet që t’i merr me seriozitet dhe t’i trajtojë kërkesat e qytetarëve dhe rekomandimet e arsyeshme të komiteteve dhe t’iu kthejë përgjigje, tha Feka, i cili shtoi se nëse do të ndodhte kjo, edhe komitetet konsideroj se do të tregoheshin serioze në punën e tyre.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se çdo rekomandim i arsyeshëm i komiteteve do të vlerësohet dhe do të merret parasysht.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se të shikohet baza ligjore dhe të gjenden masat ndëshkuese ndaj atyre që janë treguar joserioz, për mosdëgjueshmërinë e tyre.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për” dhe një (1) “kundër” kërkoi që ky raport të plotësohet dhe pastaj të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2017

Isak Hyseni, kryesues i Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta – theksoi se vetëm dy komuna e kanë themeluar këtë komitet: Komuna e Vushtrrisë dhe Komuna e Prishtinës. Hyseni deklaroi se ne si komitet kemi dhënë rekomandime për qeverinë komunale që në aspektin afatgjatë të plotësohen sado pak kërkesat e kësaj kategorie. Ai theksoi se në sektorin privat, i kemi të punësuar dy persona me nevoja të veçanta.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se rekomandimet e juaja që janë më prioritare dërgoni tek kryetari dhe nënkryetari i komunës dhe ato rekomandime që nuk kanë implikime të mëdha financiare të fillojë implementimi i tyre.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – u shpreh se ky raport prek gjëra konkrete dhe është një raport përmbledhës. Në raport është rekomanduar që të sigurohen barnat esenciale. Sigurimi i barnave nga lista esenciale është përgjegjësi e nivelit qendror, kurse përmes subvencionimit kemi mundësi të veprojmë. Tutje shtoi se nuk kemi mundësi ta realizojmë këtë, pasi që nuk varet nga ne, edhe përkundër vullnetit që kemi për ta bërë një gjë të tillë.

Isak Hyseni, kryesues i Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta – tha se fjala është për disa barna që kjo kategori ka nevojë dhe nuk po gjenden si: Fenobarbiton dhe Carbamezapine.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se do të bëj përpjekje me ndonjë kompani farmaceutike dhe ndoshta arrij ta siguroj ndonjë donacion për t’ua siguruar këto barna.

Vetëm ma sjell listën e personave, që ta di se sa është numri i tyre që përdorin Fenobarbiton dhe Carbamezapine.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – pyeti se çka do të ndodhë me objektet që janë ndërtuar dhe nuk kanë qasje për personat me nevoja të veçanta?

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se për objektet e ndërtuara po e presim ligjin e ri të legalizimit, kurse objektet që do të ndërtohen, nuk iu lëshojmë leje pa i plotësuar kriteret që kërkohen në ligj.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

10. a. Shqyrtimi i Raportit tremujor janar-mars 2018 mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – pyeti se cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet të këtij raporti tremujor me raportin tremujor të vitit paraprak?

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- theksoi se ku ka pasur dallime më shumë, në mënyrë tabelare janë paraqitur.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së –deklaroi se krahasimi është bërë shumë mirë nga ana e drejtorisë. Ai pyeti se në cilin kod ekonomik po bazohet kryetari i komunës që po i deklaroon shpenzimet javore? Sepse, është absurde që të harxhohen vetëm 13 euro për një javë, siç ka deklaruar kryetari për një javë të caktuar.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- tha se ky është një model nga Ministria e Financave lidhur me raportin tremujor. Shpenzimet e zyrës së kryetarit për këtë tremujor janë 48,096.15€. Nëse jeni të interesuar, në mënyrë detaje për zyrën e kryetarit mund t’iu ofrojmë informatat.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – pyeti se cilat të hyra hyjnë tek rubrika: “të hyrat për inspektime”, si dhe pyeti lidhur me të hyrat nga biblioteka, vetëm 37%.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – lidhur me të hyrat për inspektime sqaroi se fjala është për të hyrat nga pranimet teknike sanitare. Ndërkaq, sa i përket të hyrave nga biblioteka, ai sqaroi se fëmijët në shkollën fillore janë të liruar nga pagesa e anëtarësimit në bibliotekë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vushtrisë për periudhën 2019-2022

Miran Halili, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural- i njoftoi të pranishmit se këtë vit i skadon afati i strategjisë së kaluar, prandaj e kemi sjellë propozim-vendimin për hartimin e strategjisë.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – kërkoi që të përzgjedhet një kompani, e cila do ta hartonte një strategji të mirëfilltë për zhvillimin ekonomik të komunës.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për prona të paluajtshme.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se para disa dite në komitet kemi diskutuar se komuna jonë ka mungesë të pronave. Prandaj, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, pas kërkesës së kryetarit të komunës ka identifikuar pronat e paluajtshme, e të cilat janë nën menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, tha Lahu, i cili shtoi se janë fokusuar më tepër në qytet. Sipas tij, këto prona mund të barten në pronësi të komunës, nga Qeveria e Kosovës, mirëpo kërkohet që të shpallen me interes të përgjithshëm.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së –tha se para se të shpallen këto zona me interes të përgjithshëm, a është paraparë se çka do të ndërtohet në këto parcela? Por, duhet të kemi parasysh, sepse ekziston Plani Zhvillimor Komunal dhe se nuk mund të ndërtojmë diçka tjetër, nëse është ndryshe me këtë plan.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se është paraparë për disa zona se çfarë do të ndërtohet.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – pyeti se a janë vërtetuar këto parcela se a janë në kontest gjyqësor.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se këto prona nuk kanë asnjë kontest gjyqësor.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

d. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës të Invalidëve të UÇK-së-dega në Vushtrri për ndihmë financiare për shërimin e invalidit të UÇK-së, Isa Murati.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – lidhur me kërkesat për ndihmë financiare, kërkoi që drejtoria përkatëse t'i jap përgjigje me shkrim palës, kështu që duhet ta krijojmë një koordinim institucional.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së –theksoi se nëse ka mjete financiare, është mirë të ndihmohet ky rast. Ai shtoi se kjo kategori duhet të dallohet nga kategoria sociale, sepse është kategori më e ndjeshme.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – deklaroi se në parim jemi të pajtimit që t'iu ndihmojmë këtyre rasteve, por vetëm duhet ta gjejmë mundësinë dhe të shikohet se a ka mjete financiare.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që kjo kërkesë t'i adresohet: Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe komisionit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për subvencionimin e personave juridikë si dhe për ofrimin e ndihmave momentale të personave fizikë për shërim.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00

Bujar Klinaku

B. Klinaku
Procesmbajtës



N. Aliu
Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së